



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2023:130810  
Datë: 30.03.2024  
Numri i dokumentit: 05528838

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Mirjeta Shala, me zyrtarin ligjor Drilon Zymeraj duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësit T.GJ., nga fshati ... komuna e Gjakovës, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Ilir Rogova, nga Gjakova, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria e Arsimit, për kompensimin e ushqimit në punë, vlera e kontestit 382.00 euro, jashtë seance me datë 29 mars 2023 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET e bazuar në ligj kërkesëpadia e paditësit T.Gj., nga fshati ... komuna e Gjakovës dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria e Arsimit, që paditësit së lartcekur, në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit, për periudhën kohore nga 01.09.2020 e deri me datë 22.11.2022 respektivisht për 191 ditë të pranisë në punë, të ia paguajë shumën prej 382.00.-€, me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të filloi të llogaritet nga data 11.05.2023 (datë e parashtrimit të padisë) deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria e Arsimit, në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësit të ia paguaj shumën prej 124.00.-€, në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Paditësi, në këtë gjykatë me datë 11.05.2023 përmes të autorizuarit të tij, ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria e Arsimit, për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit, duke theksuar se i njëjti është mësimdhënës në SHMU” .. ”në Gjakove. E njëjti për periudhën nga data 01.09.2020 e deri me datën 22.11.2022 ka realizuar 191 ditë të pranisë në punë euro, gjë që vërtetohet nga vërtetimi për ditët e pranisë në punë. Meqë e paditura nuk e ia ka paguar paditësin shujtën ditore për ditët e pranisë në punë, i propozojmë gjykatës që padia e paditësit të aprovohet si e bazuar dhe të obligohet e paditura që paditësit në emër të kompensimit të shujtës ditore për 191 ditë të pranisë në punë, paditësit të ia paguaj shumën prej 382.00 euro, duke përllogaritur 2 euro për çdo ditë të kaluar në punë, me kamatën ligjore prej 8% nga dita e ushtrimit padisë e deri në pagesën definitive.

E paditura Komuna e Gjakovës, në këtë gjykatë ka parashtruar përgjigje në padi me datë 11.03.2024, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesë padinë si të pa bazuar me arsyetimin se paditësit nuk i takon ky kompensim sepse nuk është përcaktuar me kontratën e punës të cilën kontratë e ka nënshkruar paditësi dhe është pajtuar me kushtet, detyrat dhe obligimet që i ka. Po ashtu, paditësit nuk i takon ky kompensim as me Ligjin e Punës numër 03/L-212 i cili rregullon kontestet e punës e ku askund nuk e parashihet që punëtorëve të arsimit iu takon kompensimi i tillë, prandaj kërkesës së paditësit i mungon baza juridike. Kontrata Kolektive në të cilën është thirrur paditësi nuk ka fuqi ligjore sepse është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi. Kjo kontratë nuk është e nënshkruar nga Komuna e Gjakovës si autoritet i veçantë, respektivisht si njësi e vetëqeverisjes lokale si punëdhënës i vetëm i kësaj kategorie të punonjësve të arsimit. Sipas kontratave të punës parashihet për mësimdhënës që të i kenë 20 orë në javë si orë pune dhe 20 orë në javë si orë mësimi, ndërsa vërtetimet nuk qartësojnë çështjen e konkretizimit sa i përket ditëve të punës, duke theksuar se dita e plotë e punës është 8 orë pune dhe nuk mund të llogaritet si ditë pune e plotë koha prej 4 orëve punë aktive në shkollë. Tutje ka cituar dispozitën e nenit 46 par.2 të KKAK-së ku shprehimisht thotë se pagesa e tillë si për kompensimin e ushqimit bëhet brenda mundësive institucionale, ligjore dhe financiare, për çka ka konsideruar se nuk janë plotësuar kushtet e parapara në Kontratë sepse të paditurës nuk i janë ndarë mjetet financiare nga institucionet nënshkruese të Kontratës Kolektive për pagesën e shujtës. Po ashtu e njëjta është thirrur në parashkrim dhe në faktin se nuk janë shtjerrë të gjitha mjetet administrative dhe juridike sipas procedurës administrative të përcaktuar me nenin 78 par.1, 79 dhe 82 të Ligjit të Punës, duke shtuar se edhe kërkesa e paditësit është e parashkruar. Andaj, ka kërkuar nga gjykata që padinë dhe kërkesë padinë e paditësit ta refuzojë në tërësi si të pa bazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 të LPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seance dhe erdhi në përfundim se kërkesëpadija e paditësit është e themeltë dhe si e tillë u aprovua.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigje në padi, gjykata ka gjetur se paditësi është në mardhënie pune te e paditura, përkatësisht në SHMU "...” në Gjakovë dhe se i njëjti në vend punimin e tij nga data 01.09.2020 e deri me datën 22.11.2022 ka vijuar gjithsej 191 ditë pune, fakt i vërtetuar përmes Vërtetimit me numër 01/392 i datës 13.04.2023. Gjykata provës së lartcekur ia fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e saj, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e dy Kontratave Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruara në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe ajo e vitit 22.01.2021, sepse kërkesa për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit

në punës për vitin 2020 mbulohet nga kontrata kolektive e datës 18.04.2017 e ndërsa pjesa tjetër për vitin 2021, mbulohet me kontratën kolektive të datës 22.01.2021. Duke u nisur nga fakti se e paditura, paditësit nuk ia ka paguar shpenzimet e ushqimit të parapara me nenin 35 par.7 të KKKAK të datës 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021, ku është përcaktuar se: *“Të punësuarve iu njihet e drejta për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë, vlera e kompensimit të ushqimit për një ditë të pranisë në punë, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënie primare të punës në institucionet arsimore. Punëdhënësi i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve përmes restaurantit apo kuzhinës, apo ndonjë forme tjetër nuk e ka obligim pagese (2 euro), të të punësuarve për ushqim për t’u bërë kompensimin”*, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e themeltë, andaj në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit për periudhën kohore prej datës 01.09.2020 deri me datë 22.11.2022 bëri përllogaritjen në atë mënyrë ditët e pranisë në punë që për këtë periudhë kohore janë 191 ditë, i ka shumëzuar me 2, duke ia njohur shumën prej 382.00 euro.

Gjykata vlerësoi pretendimin e të paditurës në lidhje me mungesën e bazës ligjore të kërkesëpadiës me arsyetimin se Ligji i Punës nuk e ka paraparë pagesën e kompensimit për shujta, mirëpo këtë pretendim e refuzoi për shkak se baza e kërkesëpadiës rrjedh nga Kontrata Kolektive e Arsimit, e cila në nenin 2 par.1 ka përcaktuar se *“Dispozitat e kësaj Kontrate kolektive janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit Parauniversitar (parashkollor, fillor, të mesëm, të ulët dhe të mesëm të lartë, shkolla speciale e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut.”* Gjykata konsideron se kjo kontratë është marrëveshje e cila bazohet në Ligjin e Punës numër 03/L-212 ku ndër të tjera ky ligj në nenin 90 par.5, ka përcaktuar se *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”*. Andaj, për këtë arsye, gjykata konsideron se edhe pse Ligji i Punës specifikisht nuk e ka përcaktuar kompensimin për shujta, një gjë të tillë e ka paraparë Kontrata Kolektive e Arsimit, si marrëveshje kolektive në përputhje me Ligjin e Punës. Ndërsa sa i përket pretendimit se e paditura nuk është nënshkruese e kësaj kontrate, një pretendim të tillë e refuzoi për arsye se Kontrata Kolektive e Arsimit është e nënshkruar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, andaj prodhon efekt juridik ndaj punëdhënësve të cilët kanë të punësuar punëtorë që të drejtat e tyre burojnë nga kjo kontratë, në rastin konkret e paditura është punëdhënëse e paditësit dhe detyrohet për përmbushjen e detyrimeve që dalin nga kjo kontratë për paditësin.

Gjykata analizoi edhe pretendimin e të paditurës se nuk mund të llogaritet si ditë pune e plotë koha prej 4 orëve punë aktive në shkollë, mirëpo gjykata ditët e pranisë në punë i ka vërtetuar përmes Vërtetimit të lëshuar nga shkollat përkatëse ku punon paditësi dhe të njëjtës i fali besimin pasi që është e hartuar në formën e caktuar nga organi përkatës brenda kufijve të kompetencës së tij.

Si pretendim tjetër të dhënë në përgjigje në padi, se në rastin në fjalë kemi parashkrim të kërkesës, gjykata një pretendim të tillë e refuzon si të pabazuar, për arsye se konform nenit 87 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, i njëjti ka përcaktuar se *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e*

*punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”, andaj nisur nga fakti se paditësi me padi ka kërkuar që të i kompensohen shpenzimet e ushqimit për periudhën kohore prej datës 01.09.2020 deri me datën 22.11.2022, ndërsa padinë e ka paraqitur me 11.05.2023, pra brenda afatit prej tre viteve nga kur ka lindur e drejta për kërkesën nga marrëdhënia e punës, kjo pasi që kërkesa e paditësit është nga data 01.09.2020, ndërsa paditësi me datën 11.05.2023, e ka ndërpre parashkrimin,.*

Gjykata analizoi edhe pretendimet e tjera të përfaqësuesit ligjor të të paditurës dhe atë në lidhje me faktin se nuk janë shtjerrë të gjitha mundësitë ligjore në procedurë administrative për realizimin e kërkesës, mirëpo një pretendim të tillë e refuzoi pasi që gjykata nuk është e lidhur me mjetet administrative brenda institucionit përkatës kur vendos lidhur me kërkesën. Në rastin konkret, për të paditurën detyrimi për të iu kompensuar kompensimi në emër të ushqimit rrjedh nga Kontrata Kolektive e Arsimit dhe nuk duhet të jetë e lidhur me kërkesën e të punësuarit. Rrjedhimisht paditësi, si i punësuar në arsim, nuk ka qenë i detyruar që të bëjë kërkesë të veçantë për kompensim të shujtave, pasi të njëjtën punëdhënësi do të duhej t’a përmbushte në momentin që janë plotësuar kushtet për kompensimin e saj në përputhje me kontratën kolektive të lartcekur, prandaj meqë një detyrim i tillë nuk është përmbushur, ka lindur e drejta për të kërkuar kompensimin përmes rrugëve gjyqësore, siç ka vepruar në rastin konkret paditësi.

Lartësia e kamatës së përcaktuar prej 8%, i referohet nenit 382 të LMD-së dhe kamata është llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale si në pikën II të dispozitivit, u muar sipas nenit 449 dhe 452 par. 1 të LPK-së, me ç’rast paditësit iu pranua shuma e shpenzimeve në vlerë prej 124.00.€, për përpilimin e padisë shuma prej 104.00.-€, e paraparë sipas tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës Nr. Tarifor 6 dhe 17) dhe 20,00 euro në emër të taksës gjyqësore.

Prandaj, gjykata bazuar në arsyet e cekura më lartë, bazuar në nenin 143 lidhur me nenin 398 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

- Departamenti i Përgjithshëm -  
2023:130810 datë 29.03.2024

Gj y q t a r j a,  
Mirjeta Shala

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve, pas pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.